



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** dhe nenit 40, paragrafi 40.2, pika **a** të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), të nenit 8 të Udhëzimit administrativ nr. 01/2015, për transparencë në komuna, të nenit 32, shkronja **c** dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 21.12.2016, miratoi këtë

V E N D I M
PËR KONSULTA PARAPRAKE LIDHUR ME RREGULLOREN PËR
ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRRAT,
VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË
PRISHTINËS

Neni 1

Miratohet Vendimi për dërgimin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës, në konsulta paraprake publike.

Neni 2

Komisioni lidhur me vendimin e cekur në nenin 1, do të ofrojë informata të nevojshme për opinionin – qytetarët e interesuar, përmes formave të fushatës informative, kontakteve me grupe të interesit dhe palët e interesuara, për t’i testuar dhe diskutuar propozimet.

Neni 3

Konsultat paraprake publike për rregulloren e cekur në nenin 1 të këtij vendimi, do të zgjasin për periudhën prej 15 ditësh.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtorja e Administratës dhe zyrtari përgjegjës për informim i Komunës së Prishtinës.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 016-311306, më 22.12.2016

KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur. i dip.